



BASHKIA SKRAPAR

Nr. _____ Prot

Data ___/___/ 2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje mjete shpëtimi, gjenerator dhe uniforma kundra zjarrit për PNMZSH Skrapar”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Motorrë elektrike, gjeneratorë dhe transformatorë ; Pajisje zjarrfikëse ; Uniforma zjarr-fikësish

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 375 000 (një milion e treqind e shtatëdhjetë e pesëmijë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Skrapar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet

e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në pikën 2c, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabel, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme :

- a) Dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e zhvillimit të tenderit, në vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet realizuar gjatë tri viteve të fundit;

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2. Kërkesat e cilësisë dhe standarteve

Operatorët ekonomik pjesëmarrës për të vërtetuar se malrrat e ofruara, objekt i prokurimit, i plotësojnë kërkesat e cilësisë dhe standartet, duhet duhet të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të vlefshme për periudhën e ndërtimit, si më poshtë :

Çertifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente (Sistemi i menaxhimit të cilësisë)

Argumentimi: Bazuar në ligjin. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 79 dhe neni 77 pika 4, në të cilin thuhet: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”, si dhe të VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 44 pika 3, AK kërkon cilësi dhe garanci të mallrave duke qenë se objekti është i një rëndësie të veçantë. Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminues për operatorët.

Shënim: Çertifikatat e mësipërme/ekuivalente duhet të jene të leshuar nga Institucione të certifikuar/akredituara në Shqipëri ose tek ato nderkombetare dhe në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë keto certifikata në përputhje me shërbimet që ka marre persiper në marreveshjen e bashkepunimit.

2.3.3. Për pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike (Seti uniformave kundra zjarrit)

Operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare në fuqi. (Raporte testimi për copën e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë–analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).

Argumentimi: Bazuar në ligjin. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 79 dhe neni 77 pika 4, në të cilin thuhet: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike”, si dhe të VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 44 pika 1, AK kërkon garanci të mallrave nëpërmjet testimeve zyrtare të lëshuara nga laboratorë të akredituar, duke qenë se objekti është i një rëndësie të veçantë dhe siguria e këtyre materialeve ndikon në sigurinë e jetës së punonjësve të MZSH. Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminues për operatorët.

2.3.4. Kontrolli i mallit

Operatorët ekonomik në ditën dhe orën e caktuar për hapjen e ofertave, pranë Autoritetit Kontraktor, duhet të paraqesin të paketuara nga dy palë mostra për *Set uniformash kundra zjarrit* dhe ato duhet të jenë të mbyllura në një kuti jo transparente të vulosur me vulën e operatorit ekonomik. Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të sjella me përputhshmërinë e specifikimeve të kërkuara dhe të kryejë analizat e nevojshme laboratorike nëse do të shihet e arsyeshme. Mosparaqitja e mostrave është kusht skualifikimi. Mostrat e paraqitura duhet të jenë të njëjta me ato që ofrohen elektronikisht sipas katalogeve të prodhuesit.

Argumentimi: Bazuar në ligjin. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 79 dhe neni 77 pika 4, në të cilin thuhet: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike”, si dhe të VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40 pika 6, AK kërkon të kryejë kontrollin e mallrave, duke qenë se objekti është i një rëndësie të veçantë dhe siguria e këtyre materialeve ndikon në sigurinë e jetës së punonjësve të MZSH. Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminues për operatorët.

NJËSIA E PROKURIMIT

Ernest Ymeri

Arjan Zeneli

Erigerta Hebibasi
